

THIRRJE PËR APLIKIM PËR GRANTE PËR PROJEKTE STUDENTORE

1. HYRJE

Me qëllim të fuqizimit të rolit të studentëve, rritjes së aktiviteteve jashtë kurrikulare si dhe pasurimit të jetës studentore, Kolegji AAB ofron mbështetje financiare për studentët të cilët organizojnë aktivitete sportive dhe rekreative, evenimente kulturore-sociale, debate, vizita studimore brenda dhe jashtë Kosovës, dhe ngjarje të tjera të cilat fokusohen në fuqizimin e komunitetit të studentëve. Këto grante kanë për qëllim të ofrojnë rezultate konkrete brenda një afati kohor të caktuar.

2. OBJEKTIVAT E THIRRJES

Përmes projekteve tuaja, ju duhet të synoni të arrini së paku një nga objektivat e mëposhtme:

- Të rrisni pjesëmarrjen aktive të studentëve në aktivitete jashtë-kurrikulare.
- Të ngrisni vetëdijen e studentëve apo publikut të gjerë për çështje me rëndësi shoqërore.
- Të fuqizoni bashkëpunimin ndërmjet studentëve brenda dhe ndërmjet fakulteteve të ndryshme.
- Të nxisni punën vullnetare të studentëve për intervenime në komunitet.
- Të rrisni njohuritë e studentëve për kërkesat dhe mundësitë për integrim në tregun e punës.

3. AKTIVITETET E MUNDSHME

Disa nga aktivitetet e mundshme, janë por nuk limitohen në aktivitetet si në vijim:

- Kampanja vetëdijesimi,
- Debate apo tryeza diskutimi,
- Aktivitete sportive apo rekreative,
- Aktivitete kulturore,
- Ngjarje me folës motivues apo
- Vizita studimore.

4. KUSH MUND TË APLIKOJË?

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë studentët e Kolegjit AAB. Projekti duhet të ketë udhëheqësin e projektit dhe së paku 3 studentë të cilët do të jenë pjesë të projektit. Studentët të cilët kualifikohen si kandidatë për marrjen e mbështetjes financiare duhet të plotësojnë kriteret si në vijim:

- të jenë të regjistruar në njërën nga programet BA apo MA;
- të jenë të rregullt në ligjërata, që dëshmohet përmes sistemit SIS.

5. KOHËZGJATJA DHE BUXHETI

Studentët do të kenë mundësi të aplikojnë për përkrahje për një periudhë maksimum 6 muaj. Buxheti maksimal i kërkuar për financim nga kjo thirrje për një projekt nuk duhet të kalojë shumën 1.000 EUR. Buxheti total në dispozicion për këtë thirrje është 3000 Euro, që do të thotë që do mund të financohen deri në 3 projekte. Kolegji AAB mban të drejtën që të mos e shfrytëzoj shumën totale në dispozicion nëse vlerëson që aplikimit nuk plotësojnë kriteret minimale.

6. SHPENZIMET E PRANUESHME

Për t'u konsideruar të pranueshme, shpenzimet duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- janë të domosdoshme për arritjen e rezultateve të synuara në projekt;
- janë të arsyeshme dhe në linjë me propozimin narrativ;
- janë të kalkuluar saktë dhe janë të bazuara në çmimet e tregut;
- ndodhin gjatë zbatimit të grantit;
- janë të paraqitura në buxhetin e propozuar;
- nuk duhet të përfshinë paga apo mëditje për student.

7. DOKUMENTET E NEVOJSHME

Dokumentet e nevojshme për aplikim janë si në vijim:

- Formulari i aplikimit;
- Letërnjoftimi;
- Biografi e shkurtër (CV) e studentit/ës që udhëheqë projektin;
- Dëshmi se ai/ajo është i/e regjistruar në njërën nga programet BA apo MA në Kolegjin AAB .

8. DORËZIMI I APLIKACIONEVE

Studentët duhet të dërgojnë aplikacionet e plotësuara dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri më datë **29.12.2021** në emailin: **projects@universitetiaab.com** me subjekt “**Aplikim për projekt studentor/ Emri dhe mbiemri i studentit/ës**”. Vetëm aplikacionet që përmbushin të gjitha kërkesat e thirrjes të specifikuar në udhëzuesin për aplikim dhe formularin e aplikimit, do të merren parasysh për vlerësim.

9. VLERËSIMI

Aplikacionet e plota për sa i përket dokumentacionit të kërkuar, do vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit që do të emërohet për këtë qëllim. Ekipi do t'i vlerësojë aplikacionet në bazë të kriterëve si vijon:

- | | |
|---|---------|
| 1. Relevanca e projektit me objektivat e thirrjes | 20 pikë |
| 2. Lidhshmëria logjike e objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve të pritura | 20 pikë |
| 3. Ndikimi i projektit tek studentët | 20 pikë |
| 4. Kapaciteti i aplikantëve për të zbatuar projektin | 20 pikë |
| 5. Efikasiteti i shpenzimeve në buxhetin e propozuar | 20 pikë |

10. DATAT E RËNDËSISHME

Procesi	Data tentative
Publikimi i thirrjes	15/12/2021
Sesioni Informues	20/12/2021
Afati i fundit për aplikim	29/12/2021
Informimi i aplikantëve të përzgjedhur	15/01/2022